



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon Kuvendit të Komunës që :

Në mbështetje të nenit 11, 12, par. 12.2, pika c) dhe 17, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë Nr.03/L-145, si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës _____2022, miratoi këtë:

PROPOZIM

VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL (2022-2024) LIPJAN

Neni 1

MIRATOHET, Plani i Veprimit Rinor Lokal (2022-2024) në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Veprimit Rinor Lokal (2022-2024) Lipjan.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligji për Fuqizim dhe Pjesmarrje të Rinisë Nr.03/L-145, si dhe nenit 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 .

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport ka hartuar draftin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2022-2024 i cili ka qenë në konsultim publik dhe janë zhvilluar debate publike të nevojshme për të marrur vërejtjet dhe sugjerimet nga publiku.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

01Nr. 020/01-14729
Lipjan, më 17-03.2022

KRYETARI KOMUNËS

Imri Ahmeti





Komuna e Lipjanit

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sportit

PLANI I VEPRIMIT

RINOR LOKAL LIPJAN 2022-2024

Lipjan, 2022

Plani i veprimit rinor lokal është hartuar nga Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile me mbështetjen e Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sportit.

Në këtë proces janë përfshirë të rinjtë e komunës së Lipjanit të cilët jetojnë në qytet dhe në fshat, organizatat e shoqërisë civile të cilat veprojnë në Lipjanit, forumet politike rinore si dhe përfaqësuesit institucional siç janë kuvendaret e kuvendit komunal të komunës së Lipjanit.

Plani i veprimit rinor lokal 2022-2024 është hartuar nëpërmjet një procesi të gjerë konsultativ, janë zhvilluar me dhjetëra takime konsultuese me të rinj e të reja dhe me përfaqësuesit e Komunës së Lipjanit gjatë vitit 2021 me qëllim vendosjen e prioritetëve strategjike dhe objektive që ndikojnë në përmirësimin e jetës social, kulturore, ekonomike dhe përfshirjes së të rinjve në jetën publike në Lipjan.

Përmbajtja

HYRJA..... 4

METODOLOGJIA..... 5

PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL (2022-2024) LIPIAN..... 6

POLITIKAT E DRETJORATIT TË KULTURËS RINISË DHE SPORTIT NË KOMUNËN E LIPIANIT..... 6

MOBILIZIMI I RINISË PËR PJESËMARRJE, PËRFAQËSIM DHE QYTETARI AKTIVE..... 7

OFIRIMI I SHKATESIVE DHE PËRGATITJA E TË RINJVE PËR TREGUN E PUNËS..... 9

MJEDIS I SHËNDETSHËM DHE I SIGURTE PËR TË RINJTË..... 10

SHËNIMI I DITËVE QË NDËRLIDHEN ME RININË..... 11

AKTIVITETE DHE BUXHETI I PLANI I VEPRIMIT..... 12

HYRJA

Plani i Veprimit Rinor Lokal Lipjan, nënkupton politiken lokale për rini për periudhën kohore 2022-2024. Kjo është strategji gjithëpërfshirëse për të rinjtë e komunës së Lipjanit, duke u bazuar në nevojat dhe pjesëmarrjen e të rinjve. Plani i veprimit përkrahet hapat për realizimin e objektivave, realizimin e aktiviteteve, përcaktimin e përgjegjësve dhe mjeteve të nevojshme financiare.

Plani i veprimit rinor është dokument strategjik që në përmbajtjen e tij përfshin interesat vitale dhe nevojat e të rinjve për periudhën kohore 2022 - 2024. Duke pasur parasysh nevojat e mëtejme dhe realizimin e kërkesave nga të rinjtë, si dhe paraqitjen e kërkesave në rrethana të reja lidhur me zhvillimet e sotme rinore në Kosovë, ndihet një nevojë e theksuar për të vazhduar rrugën e përkrahjes së rinisë. Plani i veprimit rinor është i bazuar në një konsensus të gjerë nga të gjitha palët e interesit mbi objektivat strategjike dhe nevojat e të rinjve, si dhe në dokumentet dhe ligjet ekzistuese që autorizojnë hartimin e strategjive kombëtare qeveritare. Dokumenti strategjik trajton preokupimet e kohës së sotme të të rinjve nga moshë 15 - 24 vjeç dhe politikat ndër sektoriale në përputhje me legjislacionin në fuqi të MKRS-së.

Objektivat strategjike të përcaktuara janë¹:

1. Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfqasim dhe qytetari aktive
2. Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës
3. Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë

Qëllimi kryesor i gjithë këtyre temave është ideja e përafrimit të të rinjve kosovarë me parimet dhe praktikatat më të mira evropiane, në veçanti me nevojat që i ka rinia në vendin tonë. Është mendim pragmatik se të rinjtë kosovarë janë gjithashtu të rinj evropianë dhe si të tillë ata duhet të synojnë që të realizojnë të drejtat e njëjta sikurse edhe gjetiu në Evropë në fushën e pjesëmarrjes, edukimit, shëndetit, sigurisë njerëzore, punësimit, sportit, kulturës dhe rekreacionit. Temat që i përfshin strategjia kanë të inkuorpuar përfshirjen sociale (gjinia, etnia, rinia rurale/urbane dhe grupet tjera të marginalizuara) si qasje e përgjithshme që do të merret parasysh gjatë implementimit të aktiviteteve të planifikuara.

¹ Objektivat janë të përcaktuar sipas strategjisë nacionale të MKRS-së për vitin 2019-2023

Po ashtu, një ndër qëllimet e kësaj strategjie është edhe përkrahja e të rinjve në fushën e inovacionit dhe të ideve kreative, lëmi e cila konsiderohet si një element i rëndësishëm që ndikon në ofrimin e mundësive të reja për të rinjtë.

METODOLOGJIA

Përgatitja e Planit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Lipjanit për të Rinjtë, ka filluar gjatë kohës së zbatimit të këtij plani nga organizatat e shoqërisë civile në muajin korrik të viti 2021 dhe ka vazhduar deri në muajin janar të viti 2022. Metodologjia e cila ka ndihmuar për hartimin e Planit të Veprimit është përcaktuar përmes 6 etapave të ndryshme, ky plan është realizuar me përfshirjen e të gjithë aktoreve në komunën e Lipjanit, të cilët kanë të bëjnë me realizimin e 3 prioritetëve të identifikuar. Për të arritur deri në rezultate e këtij plani të veprimit janë aplikuar disa metoda, në të cilat është përfshirë rishikimi i ligjeve në fuqi, hartimi i strategjive nacionale, si dhe takime me aktet e ndryshme siç janë të rinjtë, organizatat e shoqërisë civile, përfaqësuesit politik forumet politike rinor.

Fazat përmes të cilave ka kaluar hartimi i këtij plani:

- 1- Faza përgatitore;
- 2- Identifikimi i prioritetëve;
- 3- Bashkëpunimi me institucione dhe drejtori të Komunës së Lipjanit;
- 4- Konsultimi me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të rinjtë;
- 5- Prezantimi publik;
- 6- Aprovimi nga Komuna e Lipjanit.

Këto etapa kanë ndihmuar në hartimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal në komunën e Lipjanit, ku përmes këtyre etapave janë realizuar takim me të rinjtë dhe me institucionet lokal të cilat kanë kontribuar në përpilimin e këtij plani .

PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL (2022-2024) LIPJAN

Plani i Veprimit Rinor Lokal Lipjan, synon që të përmirësoj gjendjen e të rinjve, duke përfshirë institucionet të qeverisë komunale dhe jo-qeveritare në identifikimin dhe pëmbushjen e nevojave të të rinjve duke gjetur mënyra dhe mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në komunën e Lipjanit.

Plani i Veprimit Rinor Lokal është dokument strategjik afatmesëm i Komunës së Lipjanit i cili orienton shërbimet rinore Për një periudhë tre vjeçare, dhe hartohet nga sektori i rinisë pranë Drejtorisë Për Kulturë, Rini dhe Sport në partneritet dhe duke u konsultuar rregullisht me aktivistëve të rinj dhe OJQ-ve Rinore.

Ky plan përcakton mënyrat e qasjes së politikave rinore komunale ndaj të rinjve në bazë të nevojave të të rinjve në komunën e Lipjanit.

Plani i Veprimit Rinor Lokal Lipjan është i dedikuar për të rinjtë e moshave 15 — 24 vjeç dhe çdo kush që i takon kësaj grup moshë do të përfitoj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, pa dallim moshe, race, gjinie dhe religjioni.

Plani promovon bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore, grupeve jo formale dhe qeverisë lokale dhe në të njëjtën kohë ndërlidh politikën ndër-sektoriale në mes të drejtorive të Komunës së Lipjanit, që ndërlidhet me të rinjtë në fushën e politikave dhe programeve rinore.

Politikat e Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Lipjanit

Sektori i rinisë në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport vepron në këto politika rinore:

- Promovimi i Vullnetarizmit
- Integrimi i grupeve të marginalizuara
- Fuqizimi i Organizatave Rinore (seminare, trajnime për aftësimin e të rinjve etj.)
- Edukim jo-formal (stimulimi i të miturëve për edukim dhe arsim)
- Përgatitja e të rinjve për tregun e punës
- Infrastruktura Rinore

DRSK në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile kanë zhvilluar takime me të rinjtë e të gjitha komuniteteve si dhe me grupet e synuara, ku si rezultat i këtyre takimeve, kanë dalë këto rekomandime:

- Të rinjtë kanë nevojë të përftojnë përvoja ndërkombëtare dhe shkëmbime njohurish në shtete të ndryshme.
- Kampanja vetëdijësuese me qëllim të ngritjes së njohurive të të rinjve lidhur me ligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, udhëzime administrative në fushën e rinisë si dhe planin e veprimit rinor lokal.
- Kampanjave vetëdijësuese për rrezikun dhe pasojat e dukurive negative.
- Angazhim më i madh i të rinjve në aktivitete rinore kulturore, sportive dhe rekreative.
- Të ndermirën veprime për rritjen e sigurisë në shkolla dhe në lokalitetet që frekuentohen nga të rinjtë

Duke u bazuar në Politikat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe MKRS-së, pas konsultimeve me organizata e shoqërisë civile, DKRS ka përcaktuar këto fusha kryesore të intervenimit:

- ✓ Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive
- ✓ Ofrimi i shkathhtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës
- ✓ Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë
- ✓ Shënimi i ditëve që ndërliohen me rininë

1. Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive

Të rinjtë konsiderohen pjesë vitale për zhvillimin e shoqërisë. Komuna e Lipjanit angazhohet që të përfshijë të rinjtë në proceset vendimmarrëse duke i nxitur të rinjtë dhe duke ju krijuar kushte që të bëhen qytetar aktiv të shoqërisë. Për të arritur këtë qëllim Komuna e Lipjanit përkrah strukturat dhe mekanizmat rinor në nivel komunal. Njëri ndër mekanizmat kryesor që ka për qëllim të bëjë përfaqësimin e të rinjve janë organizatat e shoqërisë civile të cilat veprojnë në Lipjan, e të cilat janë organe që veprojnë në bazë të ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, Neni 10 dhe Neni 11. Komuna e Lipjanit gjatë 2022 - 2024 do të përkrah edhe struktura tjera të cilat kontribuojnë në ngritjen e pjesëmarrjes së të rinjve.

1.1 OJQ-ja përfituese e këtij projekti, sipas Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, ka këto Përgjegjësi, Obligime dhe Detyra kryesore:

- Të fuqizoj organizatat rinore të komunës ku ato veprojnë për të ndërtuar një vizion të përbashkët për të rinjtë,

- Të ndërmarrë veprime gjegjëse si dhe të përgatisë Planin e veprimit për të arritur një vizion të tillë,
- Të promovoj vizionin e specifikuar në pikën 1 të këtij neni dhe t'ua përcjellë Planin e veprimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni institucioneve të pushtetit lokal dhe organeve e organizatave tjera që adresojnë çështje të rinisë në komunë,
- Të promovoj, koordinoj dhe shkëmbej përvojat e mira me organizata tjera rinore
- Të bashkëpunoj lidhur me çështjet që prekin interesat e rinisë me institucionet e tjera publike dhe private, vendore dhe ndërkombëtare.
- Të përfaqësoj organizatat rinore para institucioneve gjegjëse lokale
- T'ju ofroj mendime e këshilla organeve dhe institucioneve komunale për veprimet që ato duhet ndërmarrë lidhur me të rinjve në Komunë,
- Të paraqesë qëndrime për dokumentet ligjore dhe dokumentet e tjera sa u përket Çështjeve të të rinjtë në Komunë,
- Të marrë pjesë në hartimin, zbatimin, vlerësimin dhe drejtimin e politikave lidhur me Çështjet e të rinjve,
- Në bashkëpunim me Komunën organizon Konferencën Vjetore për Rininë e Kosovës, Të marrë pjesë dhe të kontribuoj në hartimin e propozimit të buxhetit vjetor komunal për rini,
- Të bëjë planifikimin e aktiviteteve të shërbimit rinor vullnetar dhe aktiviteteve tjera për të rinjtë,

Komuna angazhohet t'i siguroj OJQ-së përfituese e këtij projekti, një hapësirë për zyrë dhe shpenzimet komunale të kësaj zyre e Cila do të vendoset në njërën nga objektet publike që posedon Komuna, po ashtu mbulon edhe shpenzimet për qëndrueshmëri funksionale, ku përfshihen shpenzimet administrative për zyrë, shpenzimet për takime me kryesinë dhe bordin dhe shpenzime tjera që lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e OJQ-së përfituese të këtij projekti sipas rolit të saj të përcaktuar me ligj.

1.1 OJQ-ja përfituese e këtij projekti

Komuna e Lipjanit do të marr përsipër t'i mbuloj shpenzimet e domosdoshme për mbarevajtjen e punëve të menaxherit të OJQ-së përfituese e këtij projekti, duke përfshirë; mbulimin e shpenzimeve ditore për menaxherin, shpenzimet komunale dhe materiale punësë

1.2 Konferenca vjetore Rinore

Konferenca vjetore për rinin do të organizohet nga OJQ-ja përfituese e këtij projekti, në bashkëpunim me Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Lipjanit, në të cilën do të marrin pjesë edhe të rinjtë nga qytetet tjera dhe

përfaqësues të institucioneve, me qëllim të shkëmbimit të praktikave të mira dhe efektive nga të gjithë pjesëmarrësit si dhe informimin e opinionit publik për të arriturat e këtyre mekanizmave në Sektorin e Rinisë në Komunën e Lipjanit

1.3 Hulumtimi i nevojave të të rinjve për vitet 2022-2024

Duke pasur parasysh se niveli i organizimit dhe pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, sipas vlerësimit, është mjaft i ultë në zonat rurale atëherë është e domosdoshme në terren të mbliqen statistika dhe të rekomandohen institucionet pranë Komunës së Lipjanit në zgjidhjen problemeve eventuale të të rinjve. Pas analizave dhe mbledhjes së statistikave, po ashtu grupet e ndryshme rinore do të kenë mundësi që të krijojnë fokus-grupe të cilat do të ishin pjesë e trajnimeve, seminareve, projekteve si dhe fokus-grupeve të ndryshme, Ky aktivitet do të organizohet nga DRSK në bashkëpunim me OJQ-ja përfutuese e këtij projekti dhe Grupet Jo-formale,

1.4 Mbështetja e të rinjve të viseve rurale në Komunën e Lipjanit

Përmes planit të veprimit për rini 2022 - 2024 do të mbështeten të rinjtë e viseve rurale në Komunën e Lipjanit, në organizimin e aktiviteteve të tyre të ndryshme dhe duke ndikuar në përfshirjen e tyre në vendimmarrje.

1.5 Tryeza dhe debate për rritjen e pjesëmarrjen në vendimmarrje

Është e rëndësishme që të vazhdohet me ngritjen e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë që ka roli i shoqërisë civile aktive në Komunën e Lipjanit, që të rinjtë të jenë pjesë e vendimmarrjes. Sidomos në fushat që prekin jetën e tyre të përditshme, qoftë në institucionet edukative arsimore, qoftë edhe në institucionet tjera. Organizimi i tryezave dhe debateve do të ndikojë në promovimin dhe nxitjen e rritjes së kualitetit të jetës së të rinjve përmes angazhimit të tyre në jetën publike dhe proceset vendimmarrëse.

2. Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës

Kjo objektivë strategjike planifikon ndërmarrjen e dy grupeve të masave, atë të edukimit jo formal dhe të përgatitjes së të rinjve për kycje në tregun e punës. Duke u bazuar në hulumtimin e nevojave të të rinjve përmes takimeve, edukimi joformal zë një vend të rëndësishëm në kuadër të edukimit të të rinjve të komunës Lipjanit. Për këtë shkak përmes këtij plani synojmë që t'i edukojmë të rinjtë në fusha të ndryshme. Komuna e Lipjanit angazhohet që të mbështesë organizatat rinore që ofrojnë shërbime për ngritjen e

kapaciteteve të të rinjëve. Gjatë periudhës kohore 2022-2024, DKRS do të orientoj ofrimin e këtyre shërbimeve përmes thirrjeve për OJQ Rinore të cilat do të ofrojnë programe/aktivitete për edukim jo-formal.

2.1 Organizata përfutuese e këtij plani

Organizata përfutuese do të jete vendi ku te rinjtë e kanë si vend takim por edhe si vend ku mund të iniciohen dhe realizohen projektet e ndryshme me karakter rinor. Organizata përfutuese e këtij plani do të jetë vendi ku do të organizohen dhe mbahen aktivitete Për edukimin jo-formal.

2.2 Mbështetja e programeve/aktiviteteve Për Edukim jo-formal

Me qëllim që të ofroj shërbime për të gjithë të rinjtë, DKRS do f i jap përparësi programeve afatgjata dhe të qëndrueshme të cilat përfshijnë numër sa më të madh të të rinjëve mundësisht për secilin të ri të ketë qasje dhe mundësi për të marrë pjesë në aktivitete për Edukim Jo-Formal, trajnime për shkathhtësi të komunikimit dhe përmirësimi i aftësive të folurit në publik, edukim për lidership, shkathhtësi të debutuese dhe krijimin e mendimit kritik. Komuna gjithashtu ka parasysh edhe nevoja tjera specifike për grupe dhe fusha tjera me interes për ngritjen e kapaciteteve të të rinjëve.

2.3 Organizimi i trajnimeve të ndryshme për aftësim profesional dedikuar të rinjve

Drejtorati Për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me OJQ-në përfutuese e këtij projekti dhe organizatat tjera rinore, draftojnë një plan në bazë të nevojave për të ofruar shërbime, duke përfshirë trajnime per përgatitja për tregun e punës si shkrimi e CV dhe letrës motivuese, trajnim në fushën e IT-së si dhe hartim i projekteve me qëllim tërheqjen e fondeve për zhvillim të organizatave apo bizneseve.

3. Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurve për të rinjtë

Parandalimi i dukurive negative dhe edukimi shëndetësor i të rinjve, për të siguruar mjedisin e shëndetshëm dhe të sigurtë për rininë kosovare, DKRS-ja ka planifikuar dy grupe të masave, të ndarë në kujdesin për arritjen e mjedisit të shëndetshëm të rinisë, dhe në arritjen e një sigurie më të lartë për rininë kosovare dhe mbështetjen e aktiviteteve që ndikojnë në integrim shoqëror e kulturor.

3.1 Parandalimi i dukurive negative në Shkollat e Komunës së Lipjanit

Në kuadër të planit veprues mbi identifikimet dhe parandalimin e dukurive negative në shkollë, mendohet të organizohen takime, tryeza dhe debate mbi mundësinë dhe mënyrat e parandalimit për të njëjtën kohë edhe ofrimin e partneritetit si dhe përkujdesjes institucionale të të rinjve në shkollë.

4. Shënimi i ditëve që ndërliqhen me rininë

12 Gushti - Dita Ndërkombëtare e Rinisë në kuadër të ditës ndërkombëtare të rinisë, në Lipjan parashihen aktivitete gjithëpërfshirëse me të rinjtë e zonave rurale dhe urbane të të gjitha komuniteteve.

4.1 Dita e Rinisë së Lipjanit

Dita e Rinisë së Komunës së Lipjanit shënohet në kuadër të Muajit të Rinisë që organizohet nga MKRS në bashkëpunim me DKRS dhe njëherit është mobilizimi i të rinjve në tërë Kosovën në këtë rast edhe në Komunën tonë, rreth aktiviteteve të shumta që kanë për qëllim bashkëpunimi në mes të rinjve, sensibilizimi e opinionit për rolin e rëndësishëm të rinisë në shoqëri dhe përkushtimin e institucioneve dhe organizatave përkatëse ndaj rinisë. Dita e Rinisë në Komunën tonë është në muajin Shtator. Ky aktivitet organizohet në bashkëpunim me OJQ-në përfutuese të këtij projekti, organizatat rinore dhe shoqëria civile.

4.2 Organizimi i aktiviteteve rekreative me karakter garues për të rinjtë e Lipjanit

Në të kaluarën lojërat rekreative me karakter garues kanë qenë shumë aktuale dhe kanë qenë pjesë e largimit të të rinjve nga rruga. Këto lojëra do të mund të organizoheshin në pjesët rurale të komunës së Lipjanit.

Objektivat e politikës	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Institucioni përgjegjës	Institucionet partnere	Afati kohorë			Buxheti Totali
					2022	2023	2024	
Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive	Kuvendi Vjetor i OJQ-së përfituese e këtij projekti dhe shpenzimet e menaxherit të OJQ-së	Zgjedhja e organeve Drejtuese, raportimi i punës një vjeçare të OJQ-së përfituese e këtij projekti dhe puna ditore e menaxherit të OJQ-së në Lipjan	DKRS OJQ-ja përfituese	MKRS				
	Tryeza dhe debate për rolin e rinisë në vendim marrje	Nxjerrja e rekomandimeve mbi mundësinë e rinisë dhe roli i tyre në vendim marrje	DKRS OJQ-ja përfituese	OJQ-të rinore				
	Konferenca Vjetore për Rini	Nxjerrja e mënyrave të bashkëpunimit nder-komunal për forcimin e rinisë	DKRS OJQ-ja përfituese	DKRS				
	Hulumtimi i nevojave të të rinjve në zonat rurale	Mbledhja e të dhënave të sakta mbi nevojat e të rinjve në zonat rurale	DKRS OJQ-ja përfituese	OJQ-ja përfituese, OJQ-të rinore, Klubit Rinore				
	Punëtorja e trajnimeve për organizimin e punës vullnetare	Ngritja e kapaciteteve të ofrueseve të punës vullnetare dhe vullnetareve	DKRS OJQ-ja përfituese	OJQ-ja përfituese, OJQ-të rinore,				
	Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive							
	Shuma Total							
Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës	Trainim për shkathtësi të komunikimit dhe përmirësimi i aftësive të folurit në publik	Ngritja e kapaciteteve të të rinjve në shkathtësi komunikuese dhe të folurit në publik	DKRS, OJQ-ja përfituese	OJQ-ja rinore				

	Trajnim hartimi i projekteve	Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të organizatave lokal	DKRS OJQ-ja përfutuese	OJQ-ja rinore					
	Trajnim shkrimi i CV dhe letrës motivuese	Përgatitja e të rinjve për tregun e punës	DKRS, OJQ-ja përfutuese	OJQ-ja rinore					
	Trajnim në fushën e IT - mbrojtja e të dhënave personale	Aftësimi i të rinjve në ruajtjen e të dhënave personale në rrjetet social	DKRS, OJQ-ja përfutuese	OJQ-ja rinore					
	Trajnime për edukim për lidership, shkathtësitë debutuese dhe krijimin e mendimit kritik	Përgatitja e të rinjve për aftësi udhëheqëse dhe për aftësi kritike	DKRS, OJQ-ja përfutuese	OJQ-ja rinore					
	Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës								
	Shuma Total								
Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë	Tryeza me temën dukuritë negative në shkollë dhe mënyra e parandalimit	Përmes këtyre tryezave do të dëgjohet zëri i nxënësve të mësim lidhur me dukurit negative	DKRS, DKA	MASHT, OJQ-ja përfutuese					
	Shënimi i ditës ndërkombëtare të ambientit	Promovimi i rëndësisë së ruajtjes së ambientit pastimi i qyteti	Drejtoria e urbanizimit dhe arsimit dhe partner të tjerë	DKRS dhe OJQ dhe Grupet Vullnetare					
	Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë		Shuma Total						
Shënimi i ditëve që ndërlicohen me rininë	12 Gushti dita Nder-kombëtare e Rinisë	Promovimi i vlerave kulturore-sportive	DKRS	OJQ-të					
	Dita e Rinisë së Lipjanit	Mobilizimi i Rinisë, Bashkëpunimi në mes veti si dhe promovimi i rolit të rinisë në:	DKRS, MKRS	OJQ-ja përfutuese, Grupet Vullnetare					
		Shoqëri							

	Shënimi i ditëve që ndërvidhen me riniinë	Shuma Total					
	Total për vitet						
	Shuma e përgjithshme e buxhetit për PVRL 2022-2024						